



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prodato Received/Delivery		29.12.2023	3 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	7750/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1436/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1436/2023, të datës 23.11.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Vendimit KA.nr.38/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2023, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1436/2023 e datës 23.11.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.38/2023 i datës 03.11.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 15.02.2023 ka shpallur konkursin me Nr.01/2023 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Gjykatën Themelore në Pejë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është përfshirë në fazat e procedurës konkretisht listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e cekur më lartë sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve, një nga palët në procedurë ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit A.nr.913/2023 të datës 17.08.2023 ka shfuqizuar Vendimin KA.nr.17/2023 të datës 21.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe të gjitha veprimet tjera

duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje nga faza e listës së shkurtër.

Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil sipas Vendimit A.nr.913/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka vazhduar procedurën e rekrutimit për pozitën e lartcekur, ku më datë 18.09.2023 është përgatitur lista e ngushtë me nëntë (9) kandidatët që kanë plotësuar kushtet e konkursit duke përfshirë edhe ankuesen të cilët janë ftuar në testin me shkrim që është mbajtur më datë 20.09.2023, ku rezulton se ankuesja ka kaluar testin me shkrim dhe është ftuar për intervistë me gojë.

Pas përfundimit të procedurës rezulton se sipas formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve, ankuesja ka marr 327.25 pikë, kurse sipas njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të datës 28.09.2023 ankuesja nuk ka rezultuar të jetë kandidatja e suksesshme, ngase si kandidate e suksesshme është znj. me gjithsej 437.25 pikë.

Ankuesja kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm më datë 24.10.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 03.11.2023 ka nxjerr Vendim KA.nr.38/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 28.09.2023 për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja kundër Vendimit KA.nr.38/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 23.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7069/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 11.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.11.2023 me numër protokoll 7069/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.38/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë e datës 11.12.2023; Konkursin e datës 15.02.2023 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Gjykatën Themelore në Pejë; Ankesën e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankuesja; Vendimin e datës 06.09.2023 për zbatim të vendimit të Këshillit; Vendimin A.nr.913/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 18.09.2023 nga Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare i datës 28.09.2023; Porpozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar; Renditjen përfundimtare të kandidatëve i datës 22.09.2023; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Listën për përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave e datës 14.09.2023; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Procesverbalin e datës 14.09.2023 të Komisionit Përzgjedhës; Vendimin e datës 23.03.2023 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Testin me shkrim i datës 20.09.2023 i kandidatës dhe ankueses; Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për kandidaten dhe ankuesen; Kërkesën për punësim të kandidatës

e datës 27.02.2023, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 21.02.2023, Diplomën me Nr. 514, Diplomën me Nr.1682, Letër rekomandimin e lëshuar nga kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, Letër rekomandimin e datës 24.02.2023, Kontratë e datës 28.06.2017, Amendament i kontratës i datës 26.09.2017, 21.06.2018, 17.12.2018, 26.12.2019, 01.07.2020, 22.12.2020, 14.06.2021, Kontratë e datës 31.12.2021, Kontratë punë për kohë të caktuar e datës 22.09.2022, Certifikatën D-12-2, Rekomandim për punësim i datës 28.08.2009, Certifikatën e datës 10.12.2020, Gjendjen e llogarisë nga NLB Banka për periudhën 01.07.2017-31.12.2020 dhe për periudhën 01.01.2020 deri 18.09.2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.07.2013 deri 12.09.2023, Emailin e datës 14.09.2023 nga për ankuesen dhe të tjerët, Amendament i kontratës i datës 31.03.2022, Notë Verbale Ref Nr. 603-2848/17 e datës 14.12.2017, Formulari i regjistrimit të argjendit të mbajtjes në burim tatimi në të ardhurat personale i datës 12.01.2009; Kërkesën për punësim të ankuses e datës 28.02.2023, CV-në, Vendim i datës 16.06.2020, Kontratë punë për kohë të caktuar e datës 16.06.2020, Aktvendim i datës 03.06.2020, Kontratë Punësimi e datës 16.05.2016, 12.08.2016, 01.08.2017, Kontratë e Punës Nr. 06-112-516/2008 e datës 15.01.2008, Vendim i datës 15.01.2010, Kontratë e punës e datës 29.01.2010, Certifikatën e datës 11.12.2017, Letër rekomandim nga SAH, Vërtetim i datës 12.04.2016, Vendim i datës 07.11.1989, Vendim i datës 05.12.1990, Kontratë e datës 27.12.2013, Certifikatë e datës 22.03.2021, Korrik 2010, Korrik 2013, e datë 29.06.2016, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 24.02.2023 Dipoëm me Nr. 5444, Pasqyrën e llogarisë nga trusti për periudhën 23.07.2004 deri 12.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuses është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.38/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon se plotëson të gjitha kriteret e konkursit e konkretisht referuar përvojës profesionale të punës të kërkuar me konkurs; Kandidatja e suksesshme nuk ka plotësuar kushtet e konkursit sepse nuk ka përvojë pune në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe nuk ka diplomë siç kërkohet me konkurs; Jam interesuar të marr informata nga Universiteti i Pejës lidhur me diplomën e kandidatës dhe përgjigja e tyre ishte se kjo diplomë nuk korrespondon me drejtimin financiar; Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton së në konkursin me Nr. 01/2023 të shpallur më datë 15.02.2023 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Gjykatën Themelore të Pejës, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: drejtimi ekonomik, financa apo biznes.*
- *Përvoja e punës: Së paku pesë (5) vite përvojë pune.*

Kolegji i Këshillit, siç është përcaktuar edhe me Vendimin A.nr.913/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konstaton se Komisioni Përzgjedhës i emëruar për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa", ka zhvilluar procedurës nga faza e vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve dhe sipas provave të lëndës kandidatëve u janë kërkuar dëshmitë e përvojës së punës gjegjësisht dëshmi nga Trusti për kursimet

pensionale apo dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës lidhur me kryerjen e obligimeve si punëmarrës.

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, gjen se sipas konkursit tek përvoja e punës edhe ankuesja po ashtu edhe kandidatja e suksesshme, kanë plotësuar këtë kusht ngase sipas shkresave të lëndës, rezulton se kandidatja e suksesshme ka ofruar dëshmi të përvojës së punës për periudhën 01.07.2017 deri më datë 30.06.2022 dhe vazhdon në Organizatën ndërkombëtare International Management Group në pozitën Trajnere, ndërsa sipas Notes Verbale Ref. No: 603-2848/17 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme rezulton se kjo është një organizatë ndërqeveritare/Mision Diplomatik në Kosovës dhe sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale është e liruar nga tatimi, dhe për këtë kjo kandidatë për këtë periudhë është paguar me pagë bruto ku ka bashkangjitur listën e pagave të lëshuar nga NLB Banka, si rrjedhojë janë plotësuar kushtet e parapara me Vendimin me Nr. 06/29 të datës 15.05.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, po ashtu kjo kandidatë si dëshmi sipas Kontratës së Punës për Kohë të Caktuar të datës 22.09.2022 vazhdon të punoj në Këshillin Gjyqësor të Kosovës e të cilën përvojë të punës e ka të mbuluar me dëshmi të pagesës së kursimeve pensionale nga trusti. Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja posedon dëshmi të përvojës së punës ku nga data 15.01.2008 deri më datë 15.01.2014 ka qenë duke ushtruar pozitë e Drejtorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, pastaj nga data 16.05.2016 deri më datë 16.06.2020 ka qenë e punësuar në Bankën Ekonomike, ndërsa nga data 16.06.2020 deri më datë 06.01.2022 ka qenë në marrëdhënie pune në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" SH.A në pozitën Zyrtare Kryesore Financiare, e të cilat dëshmi të përvojës së punës i ka të mbuluar me dëshmi të pagesës së kursimeve pensionale nga trusti. Bazuar në këto dëshmi dhe duke u bazuar në kriteret e konkursit sa i përket përvojës së punës e që është kërkuar *së paku pesë (5) vite përvoje pune*, Kolegji i Këshillit konstaton se si kriter i konkursit nuk ka qenë përvojë pune profesionale por vetëm përvojë pune, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se të dy kandidatet kanë plotësuar këtë kriter të konkursit, kështu që pretendimi i ankueses së kandidatja e suksesshme nuk ka përvojë pune profesionale është i pa bazuar.

Ndërlidhur me pretendimin e ankueses sa i përket përgatitjes profesionale të kandidatës së suksesshme, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja e suksesshme posedon diplomën me Nr. 1682 të datës 13.07.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtinës" përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë më datë 24.10.2005 në drejtimin Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri duke marr titullin Bachelor i Shkencave Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri, si rrjedhojë, për të shqyrtuar këtë pretendim kolegji ju referua përgjigjes së datës 31.10.2023 të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" përmes të cilës thuhet: Sa i përket diplomës së lëshuar nga Fakulteti i Shkencave të Biznesit në Pejë, Diploma korrespondon me nivelin Bachelor dhe është ekuivalente me fushën e "Biznesit". Në bazë të ERASMUS SUBJECT AREA CODES" në të cilin janë të përcaktuar Fushat dhe nën fushat e studimit, sipas fushën 04, BUSINESS STUDIES AND MANAGMENT ACIENCES, titulli i fituar në Bachelor është nën fushë të cilën në tabelarin e ERASMUS e gjeni me kodin 04.4 Turism, Catering, Hotel Managment", kurse sipas tabelarit ERASMUS SUBJECT AREA CODES në piken 04.4 parashihet se diploma e kandidatës së suksesshëm korrespondon me njërin nga kriteret e përcaktuar me konkurs financiar apo biznes, ndërsa ankuesja pretendimin e saj së është interesuar të marr informata nga Universiteti i Pejës lidhur me diplomën e kandidatës dhe përgjigja e tyre ishte se kjo diplomë nuk korrespondon me drejtimin financiar, nuk e ka argumentuar me asnjë provë konkrete, kështu që pretendimi i saj është i pabazuar.

Nga konstatimet e lartcekura, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se nga vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit rrjedhë se edhe ankuesja edhe kandidatja e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e arsimimit dhe përvojës së punës të kërkuar me konkurs, dhe se mbi këtë bazë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankueses dhe kandidates së përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës"*.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh provat e lëndës, gjegjësisht sipas formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve rezulton se ankuesja është renditur e treta me gjithsej 327.25 pikë ndërsa kandidatja e suksesshme me gjithsej 437.25 pikë, kështu që duke marr për bazë numrin e pikëve të fituara nga kandidatët në këtë procedurë, Kolegji, konstaton se në bazë të dispozitave të nenit 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, parashihet se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*.

Nisur nga konstatimet si më sipër, Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, si dhe dispozitave të Rregullores së aplikuar Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil."*

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.38/2023 të datës 03.11.2023, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin e aplikuar Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ngase ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e ankueses duke vepruar në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimi i ankueses ndaj këtij vendimi është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1436/2023, datë 29/12/2023

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.